

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“BETA 2024” SHPK**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe të Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” me vullnetin e tij të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e Statutit vendosi të formoj shoqërinë:

**I. THEMELIMI**

Neni 1  
Ortaku themelues

Shoqëria “**BETA 2024**” SHPK themelohet nga ortaku i vetem **zpj. Elisabeta Buhali**, shtetase shqiptare, lindur më 31.07.1968, në Berat dhe banues në Tirane, me numër karte identiteti G85731019D.

**II. EMRI. SELIA. FORMA LIGJORE**

Neni 2  
Emri i shoqërise

Emri i shoqërisë është “**BETA 2024**” shpk.

Neni 3  
Forma ligjore

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në bazë të ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter me vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

Neni 4  
Baza ligjore

Shoqëria “**BETA 2024**” SHPK, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe dispozitat e tjera të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një kohë **mbi 10 vjet**. Veprimtaria e Shoqërisë fillon që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Biznesit, Tirana.

Neni 6  
Selia



Selia e shoqerisë është në adresën: Berat, Lagja 30 vjetori, përballë Stacionit të Autobusit, kati i I-rë. Selia e shoqerisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqerisë. Shoqeria ka të drejtë të krijojë degë, filiale ose/dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë vendit. Shoqeria mundë të marrë pjesë në shoqeri të tjera ekzistuese ose në shoqeri që në të ardhmen do të zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të ortakeve te saj.

Neni 7  
Vula

Shoqeria do të ketë vulën e saj që do të përdoret nga administratori. Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Ortakët e shoqerisë, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në

Neni 8  
Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqerisë është:

1. Import-export, tregti me shumicë dhe pakicë, kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqeri me perjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar si dhe cdo aktivitet tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimeve të shoqerisë përfshirë dhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve.

2. Do të ushtrojë aktivitet privat tregtar në formën e import-eksportit, transportit te mallrave per vete dhe te tretet, tregtimit me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore dhe jo ushqimore, prodhime bujqesore dhe blegtorale, duhan, pijë alkolike, aparatura elektrike dhe elektronike, lëndë të para për industrine ushqimore, shitje e pjesëve të këmbimit për auto e makineri të ndryshme, vajra lubrifikante, shitje karburantesh etj.


3. Peshkim, përpunim, grumbullim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë peshku, Import Eksport i tyre.

4. Perpunim dhe tregtim te mallra industriale, ushqimore, pijë, veshmbathje e konfeksione, hidro sanitare, hidraulike, elektrike, elektro shtepiake, materiale ndertimi, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, bime medicinale, eterovajore e mjeksore, plehra e prodhime kimike, etj.

5. Import-export, tregti me shumicë dhe pakicë të materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe aksesorëve të tyre, projektim, instalim, mirëmbajtje të sistemeve elektrike dhe elektronike, trajnim personeli. Shërbime në asemblimin e pjesëve kompjuterike në pajisje audio dhe video bashkë me programet përkatëse, të moduleve të programeve kompjuterike në programe të plota.

6. Blerjen, marrjen e dhënen me qera apo në përgjithësi, shfrytëzimin e pasurive të paluajtshme, perdorimin e paisjeve të shoqërise për prodhimin e artikujve të çdo lloji dhe dhënen e garancive personave të tretë.

7. Investime në sektorë të ndryshme të industrise si në fushën e shërbimeve të ndërtimit dhe të bujqësisë.



8. Në fushën e industrisë mekanike dhe në fusha të tjera për mallra konsumi në pershtatje me nevojat e tregut të brendshem shqiptar apo të huaj dhe aktivitet tregtar e turistik.

9. Në fushën e shërbimeve publike si : Ndërtim civil, industriale, turistike, bujqësore, mbi dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme për to. Ndërtim rrugë kategoria V,IV, III,II,I dhe rrugë speciale (autostrada). Veshje me asfaltobeton të rrugëve (ndërtim mbishtresë) si dhe sistemim e asfaltim sheshe. Ndërtim vepra arti të vogla deri 6 metra. Ndërtim ujësjellës kanalizime. Ndërtim vepra kullimi, ujitje tokë e impiante vaditëse. Rikonstruktion godina civile, ekonomike veshje fasadash etj. Montim dhe instalim i impianteve termike ventilimit dhe kondicionimit të ajrit dhe mirëmbajtja e tyre. Punim me metal ,dru.,”

10. Import-Eksport i materialeve për prodhim këpucësh, si lëkurë, shoje, penjë, mastiq, Perçina, materiale plastike e të tjera materiale të këtij lloji.

- Prodhim i faqeve të këpucëve e sandaleve, këpucëve të qatshme të të gjitha llojeve.
- Dhënie konsulence dhe kryerje e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mësipërme.
- Import-eksport, prodhimin dhe tregtimin e mobiljeve, divaneve dhe artikujve të tjerë të ngjashëm.

11. Import-eksport dhe tregimi me shumicë dhe pakicë të artikujve industriale veshmbathje, kancelarie, elektroshtepiakëve, të ndërtimit, guzhinës e të tjera të këtij lloji.

12. Import-eksport prodhim konfeksionesh veshmbathje, dhe tregimi i tyre me shumicë e pakicë.

13. Realizimi i kontratave marëveshjeve, ortakërive, shoqërise të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar me persona fizikë dhe juridike shqiptare apo të huaj për të realizuar operacione industriale tregtare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe në interes të shoqërisë.

Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet ose ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

### Neni 9 Kapitali

Kapitali themeltar është 100 (njëqindë) lekë, i ndarë në 1 kuotë si më vijon, znj. Elisabeta Buhali, 1 kuotë me vlerë 100 (njëqindë) lekë dhe me pjesëmarje të 100% të kuotave të kapitalit.

Kapitali do të derdhet tërësisht me aktin e themelimit. Asambleja mund të marrë vendim për rritje të kapitalit, duke përcaktuar afatin, kushtet dhe modalitetet. Kapitali mund të shtohet nëpërmjet akordimit të pasurive në natyrë apo kredite. Në interesin financiar të shoqërisë ortaku i vetem mund të kryejnë derdhje pa interes në llogari kapitale, si edhe financime me apo pa interes, duke respektuar ligjin.

Shoqëria mund të proçedojoj me rimbursime të financimit, te pjesshme apo totale, mbledhjen e fonave nga ortakët/u, me të drejtë rimbursimi, duhet tu drejtohet ekskluzivisht subjekteve që janë në perputhje me kërkesat e ligjit dhe rregulloreve, sipas rregullave te autoriteteve perkatese.

### Neni 10 Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar



Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt notarial. Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë. Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimnie pasi të jetë marrë vendimi i Ortakut të vetëm lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit tek trashëgimtarët.

**Neni 11**  
**Zmadhimi /Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Ortaku i vetëm i shoqerise mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të tij. Zvogëlimi i kapitalit themeltar do të kryhet brenda kufijve të lejuar nga ligji.

**ORGANET E SHOQËRISË**

**Asambleja e Ortakut të Vetëm**

Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Asambleja e Ortakut të Vetëm drejtton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme.

**Neni 13**  
**Asambleja e Zakonshme**

Asambleja e zakonshme vndos në cdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo merr të gjitha vendimet (emërimi dhe shkarkimi i administratorit/ëve, miratimin e bilancit të shoqërisë, etj.) me përjashtim të atyre vendimeve që në bazë të ligjit ose Statutit janë në kompetencë të Asambesë së Jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortaket e saj me **75% te votave**.

**Neni 14**  
**Thirrja dhe Përfaqësimi në Asamble**

Mbledhja e Asamblesë së Ortakut të Vetëm mund të thirret në cdo kohë nga:

- Administratori;
- Ortaku i Vetëm.
- E të tjerë konform ligjit

**Neni 15**  
**Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve**

Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër të njoftuar nga administratori/njëri prej administratorëve. Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me letër rekomande, dhe postë tjetër të regjistruar, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

**Neni 16**  
**Marrja e vendimeve**



Vendimet merren nga ortaket e saj me 75% të votave.

Neni 17  
Administrimi

Administrimi i shoqërise kryhet nga një administrator ose nga një grup administratorësh që caktohet nga Asambleja e Ortakut Të Vetëm. Administratori nuk është detyrimisht ortakë i shoqërisë. Administratori ka të drejtë të përfaqësoj shoqërinë dhe të drejtoj punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

Administratori është solidarisht përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- drejtimin e veprimitarise së përditshme të shoqërisë;
- zëvendës.
- përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendës, veçanërisht në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera të kreditit, për hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
- përgatitjen e mbledhjeve të Asambleve të Ortakut të Vetëm;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vetë ose emërimin e një kontabilisti të miratuar ose të një eksperti kontabël;
- përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që ka;
- lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
- Zhvillon veprimitari të tjera të cdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.

Shoqëria do të administrohet nga administratori dhe njëkohësisht dhe ortak i vetëm znj. Elisabeta Buhali e cila emërohet në këtë detyrë për një afat kohor prej 5 (pesë) vjetësh.

Neni 18  
Viti finanziar

Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar në 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Neni 19  
Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm dhe i paraqitet organeve tativore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës. Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të vecanta në valutë. Shoqëria mund të marrë financime nga ortaket, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Neni 20  
Të ardhurat. Dividendi



Shoqëria do të krijoje fonde rezerve për realizimin e objektit të saj. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të terhiqen nga ortaku i vetem i shoqërisë.

Neni 21  
Likuidimi

Shoqëria do të hyjë në procesin e likujdimit, nëse:

- gjendja ekonomike në Shqipëri nuk do të lejojë vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë;
- Asambleja e Ortakut të Vetëm, vendos të prishë shoqërinë.

Në mënyrë që të ndërmarrë procedurat e likujdimit, Asambleja e Ortakut të Vetëm emëron një likuidator ose nie orun likuidatorësh. I likuidatori/likuidatorët raportoinë mbi si endien e zërave të

nevojitet për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakut të Vetëm shqyrton bilancin përfundimtar dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Neni 22  
Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore në gjuhën Shqipe, për tu depozituar në Qëndrën Kombetare të Biznesit e për tu shpërndare në organet Kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tiranë me 06.06.2024

**ORTAKU i VETËM**

**ELISABETA BUHALI**

*Elisabeta Buhali'*

